



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia Kosovare e Standardizimit
Kosovska Agencija za Standardizaciju - Kosovo Standardization Agency

UDHËZUES PËR SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN E STANDARDEVE KOSOVARE SK



2023

**UDHËZUES
PËR SHPËRNDARJEN DHE SHITJEN
E STANDARDEVE KOSOVARE SK**

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Përkuftizimet
3. Korniza ligjore
4. Copyright © - E drejta e autorit
5. Sistemi Informativ për Menaxhimin e Standardeve (SMIS)
6. Ueb faqja e Agjencisë Kosovare të Standardizimit
7. Gjuhët zyrtare të standardeve
8. Çka i japin konsumatorit standardet?
9. Standardet më të kërkuara
10. Shitja e Standardeve
- 10.1. Çmimet e standardeve
- 10.2. Si të blejmë një standard?
- 10.3. Kërkesa për blerjen e standardeve
- 10.4. Zbritja në çmimet e standardeve
11. Anëtarësimi
12. Publikimet tjera të Agjencisë Kosovare të Standardizimit
13. Informacion i përgjithshëm për standarde



1. Hyrje

Ky udhëzues paraqet rregullat dhe politikat e Agjencionit Kosovar të Standardizimit për shpërndarjen dhe shitjen e të gjitha standardeve kosovare dhe dokumenteve tjera të standardizimit në formatet fizike dhe elektronike. Këto rregulla vlejnë për institucionet, bizneset, industrinë dhe të gjitha palët tjera të interesit.

Agjencia Kosovare për Standardizim (AKS), është themeluar me 25.04.2005, dhe funksionon në kuadër të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë konform ligjit nr. 06/L-019 për standardizim, i cili koordinon punën për të gjithë aktivitetin e standardizimit në Kosovë dhe është përgjegjës për hartimin, njohjen, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve në të gjithë sektorët e ekonomisë. AKS zhvillon Standarde Kosovare për të gjitha palët e interesit dhe punon së bashku me rreth 130 ekspertë të fushave të ndryshme të cilët aktivizohen në Këshillin Profesional të Standardizimit dhe në Komitetet Teknike.

2. Përkufizimet

Agjencia Kosovare e Standardizimit - organi i vetëm i administratës shtetërore për standardizim në Kosovë.

Standardizimi - aktivitet i përcaktimit të rregullave për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, për probleme aktuale apo të tjera që mund të krijohen, që ka për qëllim arritjen e një shkalle optimale të rregullit në një kontekst të caktuar. Standardizimi është aktivitet, si rezultat i një konsensusi, i realizuar nga dhe për vetë palët e interesit, bazuar në gjithë përfshirje dhe transparencë.

Standard - dokument i hartuar me konsensus dhe i aprovuar nga një organ i njohur standardizimi, i cili ofron, për përdorim të përbashkët dhe të përsëritur, rregulla, udhëzime apo karakteristika për aktivitetet apo rezultatet e tyre, që kanë për qëllim arritjen e një shkalle optimale rregulli në një kontekst të dhënë me të cilën pajtueshmëria është vullnetare, dhe i cili është njëri nga këta si në vijim:

- a) Standard ndërkombëtar - standard i adoptuar nga një organizatë ndërkombëtare e standardizimit;
- b) Standard evropian - standard i adoptuar nga një organizatë evropiane e standardizimit;
- c) Standard i harmonizuar evropian - standard evropian i adoptuar në bazë të kërkesës së bërë nga Komisioni për zbatimin e legjislacionit të BE për harmonizim;
- d) Standard kosovar - standard i Republikës së Kosovës i miratuar nga Agjencia Kosovare e Standardizimit, i cili shënohet SK; dhe
- e) Standard i harmonizuar kosovar - standard kosovar që miraton standardin e harmonizuar evropian në përputhje me ligjin dhe rregullat e standardizimit, i cili ofron prezumim të konformitetit për rregulloret përkatëse.

Dokument standardizimi - dokument i miratuar nga organizatat evropiane dhe ndërkombëtare, dhe i miratuar nga AKS, si specifikimet teknike, raportet teknike, manuallet apo marrëveshjet e veçanta teknike, respektimi i të cilit është vullnetar.

Specifikim teknik - dokument i cili përshkruan kërkesat teknike që duhet përbushur nga një produkt, proces, shërbim ose sistem dhe i cili deklaron një ose më shumë nga këto:

- a) karakteristikat e kërkuara të një produkti duke përfshirë nivelet e cilësisë, performancës, ndërveprimit, mbrojtjes së ambientit, shëndetit, sigurisë, dimensioneve dhe duke përfshirë kërkesat e zbatuara të produktit në lidhje me emrin nën të cilin shitet produkti, terminologjia, simbolet, testimi dhe metodat e testimit, paketimi, shënjimi ose etiketimi dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit;
- b) metodat dhe proceset e prodhimit të përdorura në produktet bujqësore, produktet e destinuara për konsumim nga njerëzit dhe kafshët, dhe produktet mjekësore, si dhe metodat dhe proceset e prodhimit të produkteve tjera, ku këto kanë ndikim në karakteristikat e tyre;
- c) karakteristikat e kërkuara të një shërbimi përfshirë nivelet e cilësisë, performancës, ndërveprimit, mbrojtjes së ambientit, shëndetit, sigurisë dhe duke përfshirë kërkesat e zbatuara tek ofruesi i informacionit që do të vihet në dispozicion për pranuesin;
- d) metodat dhe kriteret për vlerësimin e performancës së produkteve të ndërtimit, duke vënë kushtet e harmonizuara për vënie në treg të produkteve të ndërtimit në lidhje me karakteristikat themelore.

Program i punës së standardizimit - program pune i AKS, i cili përmban aktivitetet e standardizimit për një periudhë të caktuar kohore.

Këshill Profesional i Standardizimit - trup këshillëdhënës nga palët e interesit.

Komitet Teknik - grup i ekspertëve që veprojnë në fusha të caktuara të standardizimit.

Kodi i Praktikës së Mirë - dokument udhëzues që rrjedh nga marrëveshjet ndërkombëtare dedikuar trupave standardizuese (Kodi i Praktikës së Mirë i OBT për standardizimin aneksi 3 i marrëveshjes OBT-Barrierat Teknike të Tregut (BTT)).

Referim ndaj standardeve - referim i cili përcakton se njëra nga mënyrat, për të përbushur kërkesat përkatëse të një rregullore teknike është zbatimi i standardit përkatës.

Palë e interesit - person juridik ose fizik që në mënyrë direkte ose indirekte gjenden në një raport të caktuar me institucionin përkatës të standardizimit.

3. Korniza ligjore

Me qëllim që të jetë në hap me zhvillimet e standardizimit në nivel evropian dhe ndërkombëtar, Agjencia Kosovare e Standardizimit në vazhdimësi plotëson/ndryshon legjislationin e saj. Në këtë kuptim, korniza ligjore në fuqi e Agjencisë Kosovare të Standardizimit është:

Ligji nr. 06-L-019 për Standardizim;

Udhëzimi Administrativ nr. 08-2018 për Këshillin Profesional të Standardizimit;

Udhëzimi Administrativ 16-2018 për Komitete Teknikë;

Udhëzimi Administrativ nr. 10-2018 për Logon e AKS;

Strategjia Afatmesme e Agjencisë Kosovare për Standardizim 2020-2025;

Rregullorja e brendshme nr. 01-2019 për standardet e harmonizuara kosovare;

Rregullorja e brendshme nr. 02-2020 për rregullat dhe procedurat për hartimin, njohjen, adoptimin, miratimin dhe publikimin e standardeve evropiane si standarde kosovare;

Rregullore e brendshme 03-2022 për notifikimin e standardeve në CEN/CENELEC;

Rregullore nr. 28/2018 për mënyrën e notifikimit dhe ofrimit të informacioneve mbi rregulloret teknike, procedurat për vlerësimin e konformitetit dhe standardet;

Marrëveshja Licencë ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit dhe Komitetit Evropian për Standardizim (CEN);

Marrëveshja Licencë ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit dhe Komitetit Evropian të Standardizimit për Elektroteknikë (CENELEC).

Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit të Shqipërisë (DPS);

Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit dhe Institutit për Standardizim të Republikës së Maqedonisë Veriore (ISRSM);

Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit dhe Shoqërisë Amerikane për Materiale dhe Testim (ASTM);

Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit dhe Institutit Turk të Standardeve (TSE);

Marrëveshja e Bashkëpunimit ndërmjet Agjencisë Kosovare të Standardizimit dhe Institutit Austriak të Standardeve (ASI).

4. Copyright © - E drejta e autorit



Standardet janë dokumente teknike të cilat përgatiten nga të gjitha palët e interesuara, të cilët mblidhen dhe pajtohen bashkërisht për çështje që ju mundësojnë atyre të konkurrojnë në treg me më shumë efikasitet. Është Agjencia Kosovare e Standardizimit ajo që siguron platformën për zhvillimin e këtyre standardeve dhe standardizimit në përgjithësi.

E drejta e autorit për formën, përmbajtjen dhe e drejta e shitjes për çdo Standard Kosovar apo dokument tjetër standardizimi i takon AKS. Agjencia Kosovare e Standardizimit ka të drejtën ekskluzive dhe të drejtën intelektuale për botimin, riprodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e projekt standardeve dhe standardeve kosovare, projekt dokumenteve dhe dokumenteve kosovare të standardizimit. Të gjitha Standardet Kosovare të adoptuara nga standardet evropiane dhe ndërkombëtare, identifikohen me logon e AKS.

5. Sistemi Informativ për Menaxhimin e Standardeve (SMIS)

Agjencia Kosovare e Standardizimit tashmë përdorë sistemin Sistemi Informativ për Menaxhimin e Standardeve (SMIS), i cili ofron një portal online që e bën më të lehtë që të rishikohen dhe t'i qasemi standardeve. SIMS ofron shërbime për të gjitha palët e interesuara, me qasje online 24/7.

Ky portal ofron mundësinë për secilën palë të interesit që të përfshihet në zhvillimin e standardeve dhe monitorimin e tërë procesit. Portali themelon një forum transparent ku të gjitha palët e interesuara mund të ofrojnë të dhëna për standardet në proces, të adoptuara dhe ato të shfuqizuara, komitetet teknike, për këshillin profesional të standardizimit, kornizën ligjore, katalogun e standardeve, buletinin dhe për gjithçka tjetër që bëhet me program pune paraprakisht ose edhe në kohë reale në AKS.



SMIS iu ofron qasje më të madhe jo vetëm qytetarëve dhe bizneseve në standarde, por ajo gjithashtu e bën më të lehtë qasjen dhe identifikimin e standardeve edhe për institucionet qeveritare, etj. Kjo mundëson që rregullatorët të harmonizojnë mjedisin rregullator, për të përmirësuar para shikueshmërinë dhe për të siguruar qartësi të të gjitha kërkesave teknike.

6. Ueb faqja e Agjencisë Kosovare për Standardizim

Agjencia Kosovare e Standardizimit, ka ueb faqen e saj e cila gjenerohet drejtpërdrejt nga të dhënat të cilat zyrtarët e agjencionit i fusin në baza ditore nëpërmjet Sistemit Informativ të Menaxhimit të Standardeve (SMIS). Kjo ueb faqe ofron qasje të plotë online 24/7 për të gjitha palët e interesit, dhe atë jo vetëm për standardet e miratuara apo ato në procedurë, por edhe për kornizën ligjore; direktivat evropiane; këshillin profesional të standardizimit; komitetet teknike; fjalorin terminologjik të standardeve; katalogun e standardeve; standardet në fuqi dhe ato të shfuqizuara; shitjen e standardeve; çmimet e standardeve; dhe publikime tjera, etj.



REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E TREGTISË DHE INDUSTRIË

[Regjistrim](#) [Llogaria ime](#) [Shqip](#)

Agjencia Kosovare për Standardizim

[Lajm](#) [Standardizim](#) [Sherbime](#) [Qendra e Informacionit](#) [Kontakt](#)
0

- Komitetet Teknike
- Çfare është një standard?
- Si të bëhemi antar?
- Rreth Agjencisë

Lajm
>

Buletini 07, i standardeve kosovare është një botim informativ periodik i Agjencisë Kosovare për Standardizim (AKS). [Më shumë ... >](#)
03 Jul 2023

Këshilli Profesional i Standardizimit [Më shumë ... >](#)
27 Jun 2023

Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS), merr pjesë aktive në takimin regional të infrastrukturës së cilësishë [Më shumë ... >](#)
09 Jun 2023

Standardet e harmonizuara për pajisjet elektrike dhe elektronike dhe standardizimi [Më shumë ... >](#)
31 May 2023

Rreth Agjencisë >

Agjencia Kosovare e Standardizimit është organ kombëtar që miraton standarde, i harmonizon ato dhe si rezultat stimulon fuqishëm zhvillimin ekonomik, duke krijuar bazë për konkurrencë në rajon dhe më gjerë. Me evolucionin ekonomik dhe rritjen e kërkesave për standarde u shtrua nevoja e draftimit të një Ligji të ri për standardizim. Në përmbushje të kërkesave të kohës, AKS-ja ka hartuar Ligjin për standardizim 06/L-019 i cili është përputhje me ligjet e BE-së.

Lajm >

Buletini 07, i standardeve kosovare është një botim informativ periodik i Agjencisë Kosovare për...

[Më shumë >](#)

Këshilli Profesional i Standardizimit
27 Jun 2023 [Më shumë ... >](#)

Agjencia Kosovare e Standardizimit (AKS), merr pjesë akti...
09 Jun 2023 [Më shumë ... >](#)

Standardeve më të kërkuara

Numri Standardit	Gjuha	Status	Publikuar	Faqe	Çmim	Blej
SK SSH EN ISO 4064-1:2021	🇧🇪	published	2021-12-20	57	38 €	
Matesa uji për ujë të ftohtë të pijshëm dhe ujë të ngrohtë - Pjesa 1: Kërkesat teknike dhe metrologjike (ISO 4064-1:2014)						

7. Gjuhët zyrtare të standardeve

-Organizata Ndërkombëtare e Standardizimit ISO, zhvillon dokumente të cilat ofrojnë kërkesa, specifikime, udhëzime ose karakteristika të cilat mund të përdoren për të siguruar që materialet, produktet, proceset dhe shërbimet përshtaten me qëllimin. Deri më tani, ISO ka publikuar 24915 standarde ndërkombëtare, të cilat mund të blihen nga anëtarët e ISO ose drejtpërdrejt në ISO store. Gjuhët zyrtare të standardeve ISO janë: anglisht, frëngjisht dhe rusisht.

-Organizatata Evropiane të Standardizimit, deri më tani kanë publikuar 26144 standarde dhe dokumente standardizimi. Gjuhët zyrtare të standardeve EN janë: anglisht, frëngjisht dhe gjermanisht.

-Agjencia Kosovare e Standardizimit, deri më tani ka publikuar rreth 13123 standarde kosovare, dhe si të tilla kryesisht janë në gjuhën angleze, megjithatë një numër relativisht i vogël i standardeve janë të përkthyer edhe në gjuhën shqipe. Ndërsa titulli i secilit Standard Kosovar është në gjuhën shqipe dhe angleze.

8. Çka i japin konsumatorit standardet?

Vendosja e kërkesave që lidhen veçanërisht me shëndetin, sigurinë e jetës dhe mjedisit bëjnë që konsumatori të ketë më shumë besim në produktet që qarkullojnë në treg, në proceset dhe shërbimet e ofruara. Standardet Kosovare japin një garanci shtesë për një gjë të tillë.

9. Standardet më të kërkuara?

Seria 900

Familja e ISO 9000, jep rregullat për "Menaxhimin e Cilësisë". Kjo do të thotë që kompanitë që aspirojnë cilësi në produktet dhe shërbimet e tyre duhet të plotësojnë: kërkesat që kanë konsumatorët për cilësinë; kërkesat në zbatim të legjislacionit, duke synuar rritjen e kënaqësisë së konsumatorit; dhe përmirësim e performancës së kompanisë.

Seria 14000

Familja e ISO 14000, kujdeset kryesisht për "Menaxhimin e Mjedisit". Ato kërkojnë nga organizatat/kompanitë të: minimizojnë efektet e rrezikshme në mjedis të shkaktuara nga aktiviteti i saj; arrijnë përmirësim të vazhdueshëm të performancës së saj lidhur me mjedisin.


Seria 17000

Familja e ISO 17000, specifikon termat dhe përkufizimet e përgjithshme në lidhje me vlerësimin e konformitetit, duke përfshirë akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit dhe përdorimin e vlerësimit të konformitetit për të lehtësuar tregtinë.

10. Shitja e standardeve

10.1. Çmimet e standardeve

Agjencia Kosovare e Standardizimit, në bazë të drejtës së saj ekskluzive për adoptimin, botimin, riprodhimin, shpërndarjen dhe shitjen e standardeve nxjerr listën e çmimeve të standardeve bazuar në numrin e faqeve të standardit. Çdo standard, i cili është adoptuar si SK, e ka çmimin e vet në ueb faqe.



The screenshot shows the website of the Agency for Standardization of Kosovo (AKS). The header includes the logo and name of the Agency, along with navigation links for 'Regjistrim', 'Llogaria ime', and 'Shqip'. The main navigation bar contains 'STANDARDIZIM', 'Lajm', 'Standardizim', 'Sherbime', 'Qendra e Informacionit', and 'Kontakt'. A search bar is located on the right side of the header.

The main content area displays the product 'SK EN ISO 9001:2016'. The price is listed as 34 €. The product details include: Status: Published, Gjuha: English, Faqe: 45, Publikuar: 2016-09-20, and Regjistri Kombëtar: 9/2016. A note states that this standard is identical to ISO 9001:2015 and ISO/TC 176/SC 2. There is an 'Add to cart' button.

Below the product details, there are sections for 'Titulli Shqip' (Sistemet e menaxhimit të cilësisë – Kërkesat (ISO 9001:2015)) and 'Titulli Anglisht' (Quality management systems -- Requirements).


The left sidebar contains a list of links: 'Legjislacioni', 'Fjalori Terminologjik', 'Konsultim Publik', 'Katalogu i Standardeve', 'Rreth standardizimit', 'Komitetet Teknike', 'Direktivë', and 'Çfarë është standardi?'. The 'Lajm' section is highlighted, showing a link to 'Buletini 07, i standardeve kosovare është një botim informativ periodik i Agjencisë Kosovare për Standardizim'.

10.2 Si të blejmë një standard?

Agjencia Kosovare e Standardizimit vendos në dispozicion të palëve të interesit informacion për çdo Standard Kosovar.

Për të kërkuar standarde, nevojitet të ndiqen këto hapa:

1. Regjistriminë sistem: referohu në linkun <http://aks.rks-gov.net/>
2. Kërkimi i standardit: referohu në linkun <http://aks.rks-gov.net/>
3. Porosia e standardeve;
4. Printimi i para faturës;
5. Pagesa e faturës në bankë;
6. Pranimi i standardit.



10.3. Kërkesa për blerjen e standardeve

Kërkesa për blerjen e standardeve mund të bëhet edhe duke e dërguar atë në adresën aksinfo@rks-gov.net, ose edhe drejtë për drejtë nëpërmjet telefonit, dhe në momentin kur konfirmohet pagesa e faturës, standardi bëhet i gatshëm për blerësin.

10.4. Zbritja në çmimet e standardeve

Blerësit e standardeve mund të jenë studentë, persona (fizik apo juridik), bashkëpunëtorë, biznese, apo kushdo tjetër që ka interes për standarde. Deri më tani AKS aplikon zbritje të standardeve vetëm për anëtarë të këshillit profesional të standardizimit dhe anëtarë të komiteteve teknike.

11. Anëtarësimi

1. Çdo person juridik ose fizik, që ushtron veprimtari ekonomike në Republikën e Kosovës, ka të drejtë të anëtarësohet në Agjencinë Kosovare të Standardizimit.
2. Të drejtat, detyrimet dhe kuota e anëtarësimit përcaktohen me marrëveshje me palët e interesuara.

12. Publikimet tjera të Agjencisë Kosovare të Standardizimit

Agjencia Kosovare e Standardizimit, përgatit dhe mirëmban arkivin me standarde kosovare, evropiane, ndërkombëtare, shqyrton kërkesa të të gjitha palëve të interesit për standarde, ndihmon palët e interesit në identifikimin e standardeve, përgatit standardet për shitjen e tyre sipas ligjit në fuqi, dhe në rast kur ndonjë standard ende nuk është miratuar si standard kosovar (SK), ato procedohen me metodë të shpejtë sipas kërkesave të palëve të interesit.

Me qëllim të ngritjes së vetëdijes së palëve të interesit, Agjencia Kosovare e Standardizimit, gjithashtu përgatit edhe aktivitete dhe materiale tjera promovuese si:

- ▮ Sesione Informative;
- ▮ Ditën Botërore të Standardeve;
- ▮ Broshura;
- ▮ Fletushka;
- ▮ Fjalori terminologjik i standardeve;
- ▮ Katalogu u Standardeve Kosovare;
- ▮ Buletini i Standardeve Kosovare;
- ▮ Video promovuese për AKS, etj.

13. Informacion i përgjithshëm për standarde

Agjencia Kosovare e Standardizimit vendos në dispozicionin e të gjitha palëve të interesit informacione për çdo Standard Kosovar (kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar) standardet e reja dhe ato të shfuqizuara, standardet më të shitura, standardet më të kërkuara për konsultim, etj. Informacioni mund të merret edhe për titullin, qëllimin, pasqyrën e përmbajtjes, numrin e faqeve, çmimin, komitetin teknik, ICS, direktivën ose rregulloren teknike që i referohet standardeve kosovare, etj.

Informacion të përgjithshëm mund të merrni jo vetëm nëpërmjet ueb faqes, por edhe drejt për drejt pranë zyrave të AKS çdo ditë nga e hëna në të premte, ora 8.00-16.00. Gjithashtu mund të përdorni mjetet e informimit të vendosura në dispozicion nga AKS: telefon, web, e-mail.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government



Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia Kosovare e Standardizimit
Kosovska Agencija za Standardizaciju - Kosovo Standardization Agency